

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



Programi mësimor

SHKENCAT NATYRORE

për klasën I

Shkup, 2021

TË DHËNA THEMELORE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

Lënda mësimore	Shkencat natyrore
Lloji/kategoria e lëndës mësimore	E detyrueshme
Klasa	I (e parë)
Tema/fusha programore	<ul style="list-style-type: none"> • Njeriu dhe trupi i njeriut • Qeniet e gjalla • Materialet • Forcat dhe lëvizjet • Zëri
Numri i orëve	2 orë në javë/72 orë në vit
Pajisjet dhe mjetet	<ul style="list-style-type: none"> • fotografi nga njerëz/fëmijë nga klasa, fotografi nga bimë, sende dhe gjallesa, fotografi nga prindër/kujdestar/ndonjë i afërt i familjes dhe/ose pasardhës të gjallesave dhe njerëzve; • mjet për matjen e lartësisë (thupër prej një metri), pasqyrë(prej plastike), lupë, çantë prej pëlhure, mbështjellëse për sytë, tabelë optike, lugë metali, lodra të buta, zile ose bilbil, gota (prej letre ose plastike); • flipçarte, markera, letra për vizatime, ngjyra, vizore, gërshërë, ngjitës, ngjitës shirit, materiale vizatimi (ngjyra, furça, enë për ujë, përparëse), plastelin, mëndafsh (fill leshi), faculeta; • kuti, enë prej plastike ose rrethe prej letre; • përmbledhje nga diçka e gjallë dhe jo e gjallë (sende) ose fotografi: copa frutash, lule, gjallesa, degë, guackë e zbratur, lugë plastike, qelq, mostra prej shkëmbijsh etj.; • saksi të vogla, saksi për mbjellje, lloje farash dhe fara për mbjellje, dhe humus; • materiale të ndryshme: drurë, gurë, metale, plastikë, gumë, qelq, qeramikë, letër, tekstil dhe materiale të përpunuara nga ato; • strajca për përpunim të përmbledhjes së materialeve, pikatore, foli prej alumini, foli prej plastike, kavanozë, llastik, pambuk, qese plastike; • lodra lëvizëse për fëmijë (topa, automobilë, biçikletë etj), litar, shishe plastike me lëng sapuni, magnetë me madhësi dhe forma të ndryshme, copëza të thërmuara metalike (monedha, kapëse letrash, stoli etj.);

	<ul style="list-style-type: none"> • materiale për përpunim të rrotullueses (letër, kapëse letrash, shkop druri/plastike); • materiale për përpunimin e burimit të zërit: tel, kuti prej kartoni, oriz, bishtaja të thata, shiritë elastik ose lastiqe me gjerësi të ndryshme, kuti prej kallaji, shishe plastike, gota metalike, lugë prej metali/druri, pëlhura të ndryshme, kapelë, pambuk etj.; • instrumente të vogla muzikore (me goditje, me tela dhe me frymë), pirun akustik, lojëra, zile etj.; • fleta pune (sipas librit/doracakut).
Normativi i kuadrit mësimor	<p>Mësimin e lëndës Shkencat natyrore në klasën e parë mund ta realizojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • profesor i mësimin klasor , VII/1 ose VI/1 sipas KNK dhe 240; • profesor i edukimit parashkollor , VII/1 ose VI/1 sipas KNK dhe 240 ECTS; • padagog i diplomuar, VII/1 ose VI/1 sipas KNK dhe 240 ECTS.

LIDHËSHMËRIA ME STANDARDET KOMBËTARE

Rezultatet e të mësuarit të paraqitura në programin mësimor shpiejnë drejt marrjes së kompetencave vijuese të përfshira në lëminë e **Matematikës dhe shkencave natyrore të** Standardeve Kombëtare:

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe/ose mund:</i>	
III-A.28	t'i përdorë njohuritë themelore shkencore për të shpjeguar botën natyrore;
III-A.34	të dallojë dhe klasifikojë substancat dhe të lidhë përbërjen e tyre me vetitë e tyre;
III-A.43	të identifikojë dhe hulumtojë dukuritë në natyrën e gjallë dhe jo të gjallë;
III-A.46	të përshkruajë dhe analizojë proceset themelore fiziologjike (rolin dhe funksionin e tyre) të cilat ndodhin tek organizmat e gjalla dhe t'i paraqesë me fotografi, skema, diagrame dhe ekuacione;
III-A.47	të zbatojë njohuri për proceset jetësore themelore të cilat realizohen në nivel të organizmave me qëllim të përmirësimit të kualitetit të tij jetësor;
III-A.54	t'i sqarojë dukuritë fizike dhe të shrytëzojë konceptet shkencore në jetën e përditshme;
III-A.56	t'i sqarojë dhe t'i analizojë lëvizjet dhe efektet e forcës mbi ato;
III-A.60	t'i përshkruajë vetitë e magneteve;
III-A.61	t'i analizojnë vetitë e zërit përmes lëvizjes së grimcave dhe përcjelljes së energjisë;
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
III-B.5	kurioziteti, sistematizimi dhe inovacioni janë thelbësorë për zhvillimin e mendimit hulumtues-shkencor;
III-B.8	çdo individ është përgjegjës për ruajtjen e mjedisit natyror në mjedisin e afërt dhe më gjërë dhe duhet të zhvillojë vetëdije ekologjike dhe të veprojë në aspekt të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit jetësor;

Programi mësimor përfshin edhe kompetenca përkatëse edhe nga lëmia e **Shkrim-leximit digjital, Zhvillimit personal dhe social, Shoqëri dhe kulturë demokratike dhe Teknikë, teknologji dhe sipërmarrësi:**

<i>Nxënësi/nxënësjat di dhe/ose mund:</i>	
IV-A.2	të vlerësojë se kur dhe në çfarë mënyrë për të zgjidhur një detyrë/problem nevojitet përdorimi efektiv dhe efikas i TIK-ut;
IV-A.5	të përcaktojë se çfarë informacioni i nevojitet atij/asaj, të gjejë, përzgjedhë dhe shkarkojë të dhëna digjitale, informata dhe përmbajtje;
V-A.1	të dallojë stilet e jetesës në mënyrë të shëndetshme nga ajo e rrezikshme kur bëhet fjalë për të gjitha sferat e jetës (përfshirë shprehitë e të ngrënit, aktivitetet sportive dhe rekreative dhe sjelljen seksuale);
V-A.6	të vendosë qëllime për të mësuarin dhe vetëzhvillimin dhe të punojë për të tejkaluar sfidat që dalin gjatë arritjes së tyre;
V-A.7	të shfrytëzojë përvojat personale për ta lehtësuar mësimin dhe ta përshtatë sjelljen e vet në të ardhmen;
V-A.14	të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të reagojë në mënyrë të përshtatshme, duke treguar ndjeshmëri dhe mirëkuptim për të tjerët dhe duke shprehur shqetësimet dhe nevojat e tyre në një mënyrë konstruktive;
V-A.15	të bashkëpunojë me të tjerët në realizimin e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet individuale dhe nevojat me të tjerët duke marrë parasysh pikëpamjet dhe nevojat e tjerëve;
V-A.17	të kërkojë informacione kthyesë dhe mbështetje për veten, por edhe të japë informacione kthyesë konstruktive dhe mbështetje në favor të të tjerëve;
V-A.18	të hulumtojë, duke parashtruar pyetje përkatëse, me qëllim që t'i zbulojë problemet, t'i analizojë dhe vlerësojë informacionet dhe propozimet dhe t'i vërtetojë parashikimet;
V-A.19	të japë propozime, të shohë mundësi të ndryshme dhe t'i parashohë pasojat me qëllim që të nxjerrë përfundime dhe vendime racionale;
VI-A.3	t'i formulojë dhe argumentojë pikëpamjet e veta, për të dëgjuar dhe analizuar pikëpamjet e njerëzve të tjerë dhe për t'i trajtuar ata me respekt, edhe kur ata nuk pajtohen;
VI-A.5	të kuptojë dallimet në mes njerëzve në çfarëdo bazë (përkatësisë gjinore dhe nacionale, moshës, statusit social etj.);
VI-A.6	të njohë pjesmarrjen e stereotipeve dhe paragjykimëve tek vetja dhe të tjerët dhe të kundërshtojë diskriminim;
VII-A.1	të bëjë lidhshmërinë e njohjes së shkencës dhe zbatimin e tyre në teknikë dhe teknologji në jetën e përditshme;
<i>Nxënësi/nxënësjat kupton dhe pranon se:</i>	
IV-B.1	shkrim-leximi digjital është thelbësor për jetën e përditshme - lehtëson të mësuarin, jetën dhe punën, kontribuon në zgjerimin e komunikimit, krijimtarisë dhe inovacionit, ofron mundësi të ndryshme për argëtim;
V-B.3	arritjet personale dhe mirëqenia në masë të madhe varen nga përpjekjet të cilat i bën dhe nga rezultatet të cilat i arrin;
V-B.4	çdo veprim që ai ndërmerr ka pasoja për të dhe / ose mjedisin e tij / saj;

V-B.7	iniciativa, këmbëngulja, qëndrueshmëria dhe përgjegjësia janë të rëndësishme për zbatimin e detyrave, arritjen e qëllimeve dhe tejkalimin e sfidave në situatat e përditshme;
V-B.8	ndërveprimi me të tjerët është i dyanshëm - ashtu si ka të drejtë t'u kërkojë të tjerëve që t'i mundësojnë atij përmbushjen e interesave dhe nevojave të tij, gjithashtu ka përgjegjësi që t'u japë hapësirë të tjerëve për të përmbushur interesat dhe nevojat e tyre personale;
V-B.9	kërkimi i informatave kthyesë dhe pranimi i kritikës konstruktive çon në përparim personal në plan individual dhe shoqëror;
VII-B.5	burimet nuk janë të pakufizuara dhe duhet të përdoren me përgjegjësi;

REZULTATET NGA MËSIMI

Tema: **NJERIU DHE TRUPI I NJERIUT**

Numri i përgjithshëm i orëve: **14**

Rezultatet nga mësimi:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/ e aftë të:

- emërojë pjesët e jashtme të trupit, të shpjegojë funksionin e tyre dhe në bazë të tyre të identifikojë ngajshmëritë dhe dallimet në mes njerëzve;
- hulumtojë për kujdesin ndaj shëndetit të tij dhe higjienës personale, aktivitetin fizik dhe ushqimin e shëndetshëm;
- identifikojë ngacmimet e jashtme dhe të bëjë lidhshmërinë me shqisat.

Nxënësi/nxënësja do të pranojë se:

- ka fëmijë të cilët janë të ndryshëm për nga mënyra si u funksionojnë pjesë të veçanta të trupit ose disa nga shqisat e tyre.

Përmbajtjet (dhe nocionet):

- Karakteristikat e jashtme të njerëzve
(lartësia, mosha, ngjyra e flokëve, ngjyra e syve, ndërrimi i dhëmbëve të qumështit)
- Pjesët e trupit
(koka, flokët, sytë, hunda, buzët, mjekrra, dhëmbët, qafa, shpina, krahërori, stomaku, duart, shpatulla,

Standardet e vlerësimit:

- Përshkruan karakteristika të vetja dhe të fëmijëve të tjerë në rrethinë (ngjyra dhe gjatësia e flokëve, ngjyra e syve, dhëmbët e qumështit).
- Identifikon dhe sqaron ngajshmëritë dhe dallimet në mes fëmijëve dhe të rriturve në rrethinë (më i vjetër/më i ri, më i lartë/më i ulët etj.).
- I identifikon pjesët e jashtme të trupit.
- E sqaron funksionin e pjesëve të jashtme të trupit.
- Sqaron se si njerëzit të cilëve ju mungon ndonjë nga pjesët e jashtme të trupit funksionojnë në përditshmëri.

shuplaka e dorës, krahu, gishtërinjtë, këmba, gjuri, shputa, gishtërinjtë e këmbës)	
<ul style="list-style-type: none"> Kujdesi për shëndetin (ushqimi, aktiviteti fizik, higjiena personale, shëndeti) 	<ul style="list-style-type: none"> Identifikon ushqim të shëndetshëm kundrejt ushqimit të shpejtë. E sqaron nevojën e ushqimit të rregullt dhe të shumëllojshëm për ruajtjen e shëndetit. E sqaron nevojën për pushim dhe aktivitete fizike për ruajtjen e shëndetit. Identifikon veprime për mbajtjen e higjienës personale (larja e duarve, fytyrës dhe dhëmbëve, larja dhe pastrimi i flokëve, prerja e thonjëve) duke patur kujdes në shfrytëzimin racional të ujit si burim natyror. Dallon veshjet e pastra dhe të papastra. E sqaron rëndësinë e higjienës personale dhe veshjeve të pastra për shëndetin.
<ul style="list-style-type: none"> Shqisat dhe reflekset (syri, shikimi, lëkura, prekje, gjuha, shija, e njelmët, e ëmbël, e thartë, djegëse, e idhët, hunda, nuhatja, veshi, zëri) 	<ul style="list-style-type: none"> Identifikon ngacmime të ndryshme nëpërmjet të shqisave të tij/saj. Sqaron se si shqisat (syri, lëkura, gjuha, hunda, veshi) dhe funksionet e tyre (shikim, prekje, nuhatje, shije, dëgjim) u mundësojnë njerëzve që të jenë të vetëdijshëm për botën rreth tyre. Sqaron se si njerëzit të cilët hasin në ndonjë vështirësi lidhur me shqisat e tyre, funksionojnë në përditshmëri.
<p>Shembuj të aktiviteteve:</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësit, në grupe të vogla, me anë të vëzhgimit i përshkruajnë karakteristikat te njerëzit (mosha, lartësia etj.) dhe bëjnë krahasime në mes vetes dhe të tjerëve (ngjyra e flokëve, ngjyra e syve, ndërrimi i dhëmbëve të qumshtit etj.). Nxënësit nëpërmjet diskutimit/lojës i identifikojnë pjesët e jashtme të trupit të tyre dhe bëjnë sqarimin e funksionit të tyre. Secili nxënës i paraqet pjesët e trupit të tyre nëpërmjet vizatimit. Secili nxënës vizaton furçën dhe pastën e dhëmbëve dhe çezme prej të cilës rrjedh ujë dhe çezme prej të cilës nuk rrjedh ujë. Pastaj diskutohet për atë se kur duhet të rrjedhë ujë, e kur jo dhe pse. Nxënësit këndojnë këngë me të cilën ju vendosin emra pjesëve të trupit dhe realizojnë lëvizje të ndryshme. Nxënësit prezantohen nëpërmjet lëvizjeve të trupit dhe hapet diskutim rreth rolit të aktiviteteve fizike për shëndetin. Diskutim me të gjithë nxënësit mbi rolin e rregullshmërisë dhe llojllojshmërisë së ushqimit. Nxënësit, në grupe të vogla, diskutojnë rreth asaj se si e mbajnë higjienën personale dhe cila është rëndësia e saj për shëndetin e njerëzve dhe përfundimet nga diskutimet në grupe të vogla i prezantojnë para të gjithëve. Nxënësit nëpërmjet lojës i identifikojnë dhe ju vendosin emra shqisave të tyre dhe i sqarojnë funksionet themelore të tyre. Secili nxënës me ndihmën e prekjës i gjen sendet që ndodhen në strajcë. Arsimtari ndez një fije shkrepe me qëllim që të bëjë tym. Pastaj hapet diskutim për atë se ndaj cilës shqisë ka vepruar tymi dhe si tymi shkakton ndotjen e ajrit. 	

- Nxënësit vizatojnë në cilat vende në natyrë dhe në rrethinën më të gjerë mund të gjendet ujë (psh. burim, liqen, lum, përrua, çezme në park, ujë në shishe në shitore) dhe pastaj diskutojnë për atë se cili ujë mund të piet dhe pse.
- Arsimitari demonstron përdorimin e tabelës optike si instrument për përcaktimin e shikimit.
- Arsimitari realizon diskutim me të gjithë nxënësit për shijet e ndryshme të ushqimit (e njelmët, e ëmbël, e thartë, e idhët, djegëse).
- Nxënësit (në grupe të vogla) shfrytëzojnë produkte ushqimore (p.sh. kripë, sheqer, uthull, kakao) për dallimin e shijeve.
- Nxënësit (në çifte) identifikojnë erë të këndshme dhe të pakëndshme nga produktet e ndryshme (p.sh. parfem, qepë, lule).
- Nxënësit dëgjojnë zëra në klasë dhe jashtë saj dhe identifikojnë burimin e zërit dhe intensitetin e zërit.
- Nxënësit realizojnë eksperimente në grupe të vogla/çifte për përcaktimin e intensitetit të zërit (p.sh. shfrytëzimi i gotave të plastikës ose prej letre me vrma në bazë).
- Nxënësit bëjnë detyra (p.sh. të sjellin mjete nga pjesa tjetër e klasës, të vizatojnë diçka sipas udhëzimit) duke nxitur situata kur kanë dorë të lidhur, mbulesë në sy, kufje në veshë. Mandej diskutojnë se si e kanë bërë atë me ç'rast konkludojnë se njerëzit me pengesa të caktuara mund të funksionojnë në mënyrë të suksesshme në jetën e përditshme.

Tema: QENIET E GJALLA

Numri i përgjithshëm i orëve: 20

Rezultatet e mësim:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë të:

1. identifikojë njerëzit, gjallesat dhe bimët si qenie të gjalla dhe ju vendos emra dhe i Opërshkruan dallimet themelore në mes tyre,
2. sqarojë karakteristikat themelore të qenieve të gjalla (bimët, kafshët dhe njerëzit).

Përmbajtjet (dhe nocionet):

- Bimët
(rrënja, kërcelli, gjethi, lulja, fruti, fara)
- Kafshët
(kafshë, kafshë shtëpiake, kafshë të egra)

Standardet e vlerësimit

- Identifikon qenie të gjalla dhe bën klasifikimin në pajtim me përkatësinë e tyre (kafshë, bimë).
- Ju vendos emra pjesëve të bimëve në modelin e dhënë (bimë natyrale ose artificiale, ilustrim të bimëve etj.)
- Përshkruan se si prej farës bëhet bima.
- Sqaron se bimëve ju nevojitet dritë dhe ujë që të rriten.
- E njih nevojën për kujdes ndaj bimëve (barin, lulet, drunjtë).
- Njih dhe ju vendos emra shtazëve të ndryshme (kafshë shtëpiake, kafshë të egra).
- Bën dallimin në mes kafshëve duke u bazuar në karakteristika të veçanta (mënyra e ushqimit, mënyra e lëvizjes).
- Bën dallimin në mes kafshëve të egra dhe kafshëve shtëpiake.

	<ul style="list-style-type: none"> • Njeh dhe ju vendos emra vendbanimeve ku jetojnë kafshët shtëpiake, kafshët e egra.
<ul style="list-style-type: none"> • Karakteristikat e qenieve të gjalla (njerëz, bimë, gjallesa, lindje, rritje, ushqimi, plakje, ujë, burime të ujit, prindër, pasardhës, mace-kotele, pelë-mëz, patë-i vogli i patës, dele-qingj, dhi-kec, bebe, fëmijë, djalë, vajzë, i rritur, plakë/plaka) • Dallimi në mes të gjallës dhe jo të gjallës (e gjallë, jo e gjallë) 	<ul style="list-style-type: none"> • Sqaron se qeniet e gjalla (bimët, kafshët dhe njerëzit) lindin, rriten dhe ndalojnë së jetuari. • E sqarojnë rëndësinë e ushqimit dhe ujit për mbijetesën e qenieve të gjalla (bimët, kafshët dhe njeriun). • Emëron pasardhësit e kafshëve. • Identifikon faza të ndryshme të ciklit jetësor të njeriut (bebe, fëmijë, djalë, vajzë, i rritur, plakë/plaka) dhe jep sqarime mbi karakteristikat e secilës fazë zhvillimore. • Identifikon dhe sqaron dallimet në mes qenieve të gjalla dhe gjësendeve jo të gjalla (gurë, lugë, qelq, ujë, laps kimik, lule artificiale).
<p>Shembuj të aktiviteteve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit, në grupe të vogla, çifte, nëpërmjet prezantimeve vizuale i klasifikojnë qeniet e gjalla të kafshëve dhe bimëve dhe diskutojnë për karakteristikat themelore të tyre. • Nxënësit në fletë pune të ilustruar përcaktojnë se për cilën shtazë/bimë bëhet fjalë, ku jeton ose rritet, a përdor ushqim të gatshëm ose vetë e prodhon, a lëviz dhe si lëviz, a ka nevojë për dritë që të rritet, a ka lule, fruta ose fara, a ka bebe etj. • Arsimtari, me ndihmën e prezantimit vizual tregon bimë të ndryshme, ndërsa nxënësit e përshkruajnë dallimin në mes tyre (bar, fruta, perime dhe bimë të tjera). • Në oborrin e shkollës nxënësit vëzhgojnë bimët (p.sh. drunj, bar, lule) dhe i identifikojnë pjesët e tyre. Aktivitetin e njëjtë mund ta realizojnë me anë të modelit të bimëve në shkollë. • Nxënësit në mënyrë të pavarur përpilojnë copëza për bashkim të figurës me pjesë të bimës. • Nxënësit, në grupe të vogla përpunojnë modele të bimëve duke përdorur materiale të ndryshme (plastelin, mëndafsh (fill leshi), fyshta (gyptha), faculeta etj.). • Nxënësit, në grupe të vogla/çifte, realizojnë eksperiment për mbjelljen e farës (mbjellje të grurit në pambuk/ dhé, në lëvoren e vezës ose fasule në pambuk/dhé) dhe ilustrojnë tregim në të cilën i paraqesin fazat e mbjelljes së farave dhe rritjen e bimëve. • Nxënësit, në grupe të vogla, bëjnë dallimin në mes bimëve që janë ujitur dhe që nuk janë ujitur (gjatë kushteve të tjera të njëjta), si dhe bimëve të mbajtura në dritë dhe në errësi (gjatë kushteve të tjera të njëjta). • Arsimtari prezanton përmbledhje të farave dhe nxënësit i ndajnë në lloje të ndryshme të farave. • Nxënësit, në grupe të vogla/çifte, shohin frute të ndryshme dhe farat e tyre dhe bëjnë dallimin në mes tyre. • Diskutim me të gjithë nxënësit për llojet e kafshëve (kafshë shtëpiake, kafshë që i kemi në shtëpi, kafshë të egra, kafshë të zbutura), përcaktimin dhe ilustrimin e tyre. • Secili nxënës vizaton kafshën e butë që ka në shtëpi/ ose do të kishte dashur që ta ketë dhe pastaj diskutojnë se si duhet të kujdesen për të. 	

- Nxënësit bëjnë modele të kafshëve të buta ose të egra nga materiale të ndryshme (lloje të ndryshme të letrave, mëndafsh (fill leshi), plastelin etj.), sipas zgjedhjes së tyre. Në fund secili nxënës e përshkruan kafshën e tij sipas ndonjë karakteristike (p.sh. me se ushqehet, si lëviz, ku jeton etj.).
- Nxënësit, në grupe të vogla, marrin rolin e kafshës ose bimës dhe nëpërmjet lojës e gjejnë vendbanimin e tyre paraprakisht të vendosur në klasë.
- Arsimtari me ndihmën e prezantimit vizual tregon karakteristikat e bimëve/ose kafshëve, ndërsa nxënësit në diskutim të përbashkët sjellin përfundime se cilat janë karakteristikat e qenive të gjalla.
- Nxënësit në fletë pune të ilustruar njohin kafshë të ndryshme, ju caktojnë emra të vegjëlve të tyre dhe bëjnë lidhshmërinë e prindërve me pasardhësit (mace/kotele, pelë/mëz, patë/i vogli i patës, dele/qengj, dhi/kec etj.).
- Nxënësit, në grupe të vogla, shohin fotografi të njerëzve në faza të ndryshme të ciklit jetësor të njeriut (bebe, fëmijë, djalë, vajzë, i rritur, plakë/plaka) dhe i përcaktojnë sipas rënditjes së drejtë të ciklit jetësor.
- Arsimtari tregon fotografi të qenieve të gjalla (bebe, mace, lepur, qen, zog, lule, dru etj.) dhe gjësende jo të gjalla (gurë, lugë, qelq, kimik, lule artificiale etj.), ndërsa nxënësit identifikojnë se çfarë është e gjallë dhe jo e gjallë dhe diskutojnë për karakteristikat e tyre.

Tema : MATERIALET Numri i përgjithshëm i orëve: 13	
Rezultatet nga mësimi: Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë të: <ol style="list-style-type: none"> 1. njohë lloje të ndryshme të materialeve; 2. dallojë përbërjen e materialit dhe t'i klasifikojë sipas përbërjes së tyre; 3. bëjë lidhshmërinë e zbatimit të materialeve me përbërjen e tyre. 	
Përmbajtjet (dhe nocionet):	Standardet e vlerësimit
<ul style="list-style-type: none"> Llojet e materialeve (materiale, dru, gurë, metal, plastikë, gomë, qelq, qeramikë, letër, tekstil) 	<ul style="list-style-type: none"> Ju vendos emra materialeve të ndryshme nga rrethina. Identifikon lloje të materialeve nga rrethina. Klasifikon objekte të ndryshme sipas llojit të materialit prej çfarë janë të përpunuara.
<ul style="list-style-type: none"> Vetitë e materialeve (veti, e fortë, e butë, e lëmuar, e ashpër, elastike, kundër lagështisë, e thyeshme, e tejdukshme, e ndritshme, magnetike) 	<ul style="list-style-type: none"> Njih cilësi të ndryshme të materialeve me ndihmën e shqisave të veta. I përshkruan materialet në bazë të vetive të tyre. Identifikon pjesmarrje të vetive të caktuara të materialeve të ndryshme. Bën dallimin në mes vetive të ndryshme të materialeve (e fortë/e butë, e ashpër/e lëmuar, rezistues ndaj ujit/jorezistues ndaj ujit etj.). Klasifikon materiale sipas vetive të dhëna.
<ul style="list-style-type: none"> Zbatimi i materialeve 	<ul style="list-style-type: none"> Numëron materiale të ndryshme për zbatim të caktuar. Bën lidhje mes vetive të materialit dhe zbatimit të tyre. E sqaron zbatimin e materialeve varësisht nga përbërja e tyre.
Shembuj të aktiviteteve: <ul style="list-style-type: none"> Nxënësit, në grupe të vogla/çifte, kërkojnë sende nga materiale të ndryshme në klasë dhe tregojnë materialet prej se janë të ndërtuara. Nxënësit luajnë lojë “prek dru/metal/plastik ...” në klasë ose jashtë klasës. Nxënësit, në grupe të vogla/çifte, i klasifikojnë sendet e ofruara sipas llojit të materialit prej të cilave janë të ndërtuara. Secili nxënës plotëson fletë pune të ilustruar në të cilën bën lidhshmërinë e sendeve të dhëna me llojin e materialit prej të cilit është përbërë. Arsimtari realizon diskutim me nxënësit mbi vetitë e materialeve. Më pas, nxënësit në grupe/çifte, identifikojnë vetitë e materialeve të dhëna dhe me ndihmën e shqisave të tyre i përshkruajnë materialet. Nxënësit, në grupe të vogla, realizojnë eksperimente gjatë të cilave zbulojnë veti të caktuara të materialeve të ndryshme (për shembull: zbulimin e rezistencës së ujit pas vendosjes në plastikë, qelq, metal, letër, tekstil etj. dhe ndjekje të depërtimit, zbulimin e elasticitetit me tërheqje të gomave, tekstilit, drurit, plastikës etj.). Nxënësit, në grupe të vogla, vëzhgojnë materiale të ndryshme dhe realizojnë eksperimente me të cilat zbulojnë përbërjen e tyre të përbashkët: fortësinë, me shqisën e të prekurit dhe rezistueshmërinë, duke derdhur ujë). 	

- Nxënësit, në grupe të vogla, realizojnë eksperimente nëpërmjet të cilave demonstronjë përbërjet e kundërta të materialet (e fortë/e butë me shqisat e të prekurit të qeramika dhe goma, e lëmuar/e ashpër me shqisat e të prekurit; magnetike/jo magnetike me afrim të magnetit kah metali dhe letra etj.).
- Nxënësit, në grupe të vogla/çifte, i klasifikojnë sendet e ofruara sipas vetive të materialeve prej të cilave është ndërtuar.
- Arsimitari, me ndihmën e prezantimit vizual, tregon shembuj të materialeve të ndryshme, ndërsa nxënësit tregojnë se këto materiale ku gjejnë zbatim në amvisëri.
- Arsimitari prezanton ilustrime me sende me përdorim të caktuar, nxënësit propozojnë materiale të përshtatshme prej të cilave duhet të përbëhen.
- Secili nxënës plotëson fletë pune të ilustruar me të cilën bën lidhshmëri të sendeve nga jeta e përditshme me vetitë e materialeve të përdorura.
- Nxënësit, në grupe të vogla, përpunojnë sende nga materiale të caktuara dhe bëjnë testimin se vallë a janë të përshtatshme për qëllimin e caktua (p.sh. barkë prej letre, barkë prej fletëve të aluminit, ombrellë prej mëndafshi (fill leshi), kapelë prej letre, kapak për kavanoz prej plastike, mbulesë prej pambuku dhe tekstili, mbulesë mbrojtëse nga uji e përpunuar nga qese prej plastike etj.).

Tema: FORCAT DHE LËVIZJET

Numri i përgjithshëm i orëve: **14**

Rezultatet e mësimi:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë të:

1. krahasojë lëvizjet e trupit të vet, lëvizjen e gjallesave dhe lëvizjen e objekteve;
2. njohë forcën si shkak për lëvizje dhe ndryshimin e shpejtësisë së trupit nëpërmjet shtyerjes dhe tërheqjes;
3. zbulojë forcat magnetike nëpërmjet tërheqjes trup/magnet, magnet/magnet dhe refuzimit magnet/magnet.

Përmbajtjet (dhe nocionet):

Standardet e vlerësimit:

- Lëvizja

(lëvizje, ecje, vrapim, kërcim, rrotullim, rrëshqitje, luhajtje, rrotullim në rreth, fluturim, notim, lëvizje e shpejtë, më shpejt, shumë më shpejt, lëvizje e ngadalshme, më e ngadalshme, ndalim)

- Sqaron lëvizjet e trupit të vet si tërësi dhe lëvizjet e pjesëve të trupit.
- Dallon mënyrat e lëvizjes të gjallesat dhe i krahason me lëvizjet e njeriut.
- Bën dallimin mes lëvizjeve shpejt, më shpejt, shumë shpejt dhe ngadalë, më ngadalë, shumë ngadalë.
- Klasifikon lëvizje të objekteve dhe gjallesave të ndryshme sipas mënyrës së lëvizjes dhe sipas shpejtësisë së lëvizjes .

- Forca

(shtyrje, tërheqje, forca, lëvizje e nxituar, sipërfaqe e lëmuar, sipërfaqe e vrazhdë)

- Dallon shtyrjen dhe tërheqjen.
- Identifikon se gjatë shtyrjes dhe tërheqjes shfrytëzohet forcë, duke marrë për bazë edhe forcën e vet.
- Sqaron se forca është arsyeja për nxitim, ngadalësim dhe ndryshim të drejtimit të lëvizjes së trupit.
- Identifikon burimet e forcës (era, motori, uji që lëviz etj.) tek objektet e ndryshme në lëvizje.

	<ul style="list-style-type: none"> • Sqaron se shpejtësia dhe ngadalësimi i lëvizjes së trupit, nën veprimin e forcës, varet nga lloji i sipërfaqes në të cilën lëviz.
<ul style="list-style-type: none"> • Forcat magnetike (forca magnetike, magneti, tërheqje, shtyrje, magnete më të dobëta, magnete më të forta) 	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon sende të cilat tërhiqen me magnet dhe sende të cilat nuk tërhiqen me magnet. • Identifikon forca magnetike nëpërmjet tërheqjes të sendeve të caktuara nga ana e magnetit. • Dallon forca tërheqëse magnetike dhe forca shtyrëse magnetike. • Përfundon se magnetët, pa marrë parasysh madhësinë e tyre, kanë veprim magnetik të ndryshëm (më i fortë, më i butë).
<p>Shembuj të aktiviteteve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Arsimtari bashkë me nxënësit demonstroi dhe udhëheq diskutim për lloje të ndryshme të lëvizjeve (ecje, vrapim, kërcim, rrëshqitje, luhatje, rrotullim në rreth, notim etj.). • Nxënësit lëvizin me ritëm të muzikës të cilën e dëgjojnë dhe i realizojnë lëvizjet e tyre, sipas shpejtësisë dhe llojit të lëvizjes (ecje, vrapim, kërcim, luhatje, rrotullim etj.). • Nxënësit, në grupe të vogla/çifte, nëpërmjet prezantimit vizual, i klasifikojnë kafshët sipas mënyrës së lëvizjes (zogjtë, bleta, flutura/fluturojnë; peshqit, delfinët, balenat/notojnë; lepujt, kengurët, karkalecat/kërcejnë; kali, luani, tigri, struci/vrapojnë etj.). • Arsimtari demonstroi lloje të ndryshme të lëvizjeve të objekteve (objekte nga klasa, lodra, mjete transportuese etj.) dhe kafshëve, përderisa nxënësit i klasifikojnë në të shpejtë, më të shpejtë, shumë të shpejtë dhe të ngadalshëm, më të ngadalshëm, shumë më të ngadalshëm. • Arsimtari demonstroi dhe realizoi diskutim me nxënësit për lëvizjet e gjësendeve të ndryshme të njohura për nxënësit (top, gjarpër, barkë, automobil, lodra të ndryshme, biçikletë etj.). • Nxënësit me shtyrje dhe tërheqje lëvizin mjete të ndryshme në klasë. • Nxënësit në fletë pune të ilustruara përcaktojnë dhe krahasojnë mjetet të cilat lëvizin me shtyrje dhe mjetet të cilat lëvizin me tërheqje. • Nxënësit në grupe bëjnë gara me tërheqjen e litarit. • Nxënësit demonstrojnë shtyrjen me gjuajtjen dhe hedhjen e topit. • Nxënësit bëjnë fluska prej sapunit dhe e diskutojnë mënyrën e shpërndarjes së tyre. • Nxënësit bëjnë përpunimin e letrës rrotulluese dhe bëjnë analizimin e lëvizjes /rrotullim në oborrin e shkollës ku kemi erë (më shpejt në drejtim të erës dhe më ngadalë në drejtim të kundërt të erës) dhe pa erë. • Nxënësit luajnë lojëra gjatë së cilave ndiqen dhe u jepen kahje nga arsimtari dhe bëjnë ndërrimin e lëvizjeve të tyre (para-mbrapa, majtas-djathtas). • Nxënësit, në grupe të vogla, diskutojnë mbi burimet e forcës e cila shkakton lëvizje të mjetet/ lodrat e ndryshme (topa, lojra me motor/ mekanizmi i zhvendosjes, karrocë për shtyrje/tërheqje, gjethë prej peme, biçikletë, automobil, avion, fluturake etj.). • Nxënësit, në grupe të vogla, me vetura për fëmijë, zbulojnë se si shpejtësia dhe ngadalësimi i lëvizjes së automobilit varet nga lloji i sipërfaqes ku lëviz (p.sh. dyshe me prej pllakave, tokë, gjelbërim, asfalt, dyshe me prej druri etj.). 	

- Nxënësit, në grupe të vogla, zbulojnë se cilat objekte tërhiqen prej magnetit dhe të cilat nuk tërhiqen prej magnetit (monedha, letërkapëse, gërshërë, letër, bizhuteri etj.).
- Nxënësit në grupe të vogla demonstrojnë forcat tërheqëse të magnetëve, trup/magnet, magnet/magnet dhe forca shtyrëse të magnet/magnet.
- Nxënësit në grupe të vogla/çifte, realizojnë eksperimente nëpërmjet të cilave zbulojnë intensitetin e magnetëve të ndryshëm pa marrë parasysh madhësinë e tyre (p.sh. numrin e letërkapëseve të ngjitura në magnet).

Tema: ZËRI
 Numri i përgjithshëm i orëve: **11**

Rezultatet e mësimit:
 Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë të:

1. krahasojë zërat e ndryshëm, të identifikojë burime të zërit dhe të sqarojë mënyrën me të cilën shkaktohet zëri;
2. njohë burimet e zërit të instrumenteve muzikore dhe sqaron se si shkaktohen zërat në instrumente;
3. demonstrojë dhe sqarojë ndryshime të intensitetit të zërit gjatë përcjelljes së tij.

Përmbajtjet (dhe nocionet):	Standardet e vlerësimit:
<ul style="list-style-type: none"> • Zëri dhe burimet e zërit (zëri, toni, i ulët, i lartë, i këndshëm, i pakëndshëm, dëgjim, burim i zërit) 	<ul style="list-style-type: none"> • Njeh zëra të ndryshëm dhe i identifikon burimet e tyre. • Paraqet shembuj të burimeve të ndryshme të zërit nga rrethina. • Bën lidhshmërinë e zërit me shqisat e dëgjimit. • Bën dallimin në mes zërit të ulët dhe të lartë, zërit të këndshëm dhe të pakëndshëm (muzikë e qetë, muzikë e lartë, zhurmë, dridhje, sirena etj.). • Sqaron se objektet me zhvendosje formojnë zë.
<ul style="list-style-type: none"> • Zërat muzikor (instrumente muzikore, zërat muzikor) 	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon zëra nga instrumente të ndryshme muzikore. • Bën dallimin mes shumë burimeve të zërave muzikorë (instrumente me tela, me goditje dhe me frymë). • Sqaron se si instrumentet muzikore e shkaktojnë zërin. • I njeh lëvizjet të cilat shkaktohen nga zëri. • Krijon burime të zërave muzikore.
<ul style="list-style-type: none"> • Përcjellja e zërit 	<ul style="list-style-type: none"> • Sqaron se zëri udhëton nga burimi deri te shqisa e dëgjimit. • Përfundon se me largimin e burimit, zëri bëhet më pak i ndjeshëm, më i dobët dhe më i paqartë. • Interpretin se zëri bëhet më i ulët, më i dobët dhe më i paqartë në qoftë se në mes burimit dhe shqisës së dëgjimit vendoset pengesë.

Shembuj të aktiviteteve:

- Nxënësit dëgjojnë zëra të ndryshëm në klasë dhe jasht klasës dhe e identifikojnë burimin e tyre.
- Diskutim me të gjithë nxënësit për burimet e zërit nga rrethina.

- Nxënësit shkaktajnë zëra të ndryshëm me ndihmën e: trupit të tyre (përplasje e duarve, përplasje e këmbëve, fishkëllima me gojën etj.), mjete të ndryshme (gota metalike, tenxhere, gota plastike, lugë prej druri/metalike etj.), instrumente muzikore etj.
- Nxënësit në grupe, nëpërmjet lojërave (telefoni i prishur), zbulojnë se ne dëgjojmë kur zëri hyn në veshin tonë.
- Arsimtari demonstroi lloje të ndryshme të zërit, ndërsa nxënësit i klasifikojnë në të ulët dhe të lartë, të këndshëm dhe të pakëndshëm.
- Arsimtari hap diskutim me të gjithë nxënësit për mënyrën e formimit të zërit dhe regjistrimin e tij në shqisën e të dëgjuarit.
- Nxënësit, në grupe të vogla, shkaktajnë zëra me ndihmën e instrumenteve të ndryshme muzikore dhe e zbulojnë mënyrën e shkaktimit të zërit.
- Arsimtari realizoi diskutim me të gjithë nxënësit për burimet e zërave muzikorë.
- Nxënësit, në grupe të vogla/çifte, demonstrojnë shkaktimin e zërave të ulët dhe të lartë me instrumente të ndryshme muzikore.
- Arsimtari demonstroi efektet që i shkakton zëri (goditje në daulle në të cilën janë vendosur kokra orizi, vendosje të fletës prej letre me kripë ose sheqer afër burimit të zërit ku dëgjohet muzikë etj.).
- Nxënësit, në grupe të vogla, përpunojnë burime të zërave muzikorë (instrumente muzikore për fëmijë).
- Nxënësit realizojnë eksperimente, në grupe të vogla/çifte, nëpërmjet të cilës zbulojnë lidhjen e intensitetit të zërit dhe largësinë e burimit të zërit.
- Nxënësit realizojnë eksperimente, në grupe të vogla/çifte, nëpërmjet të cilave zbulojnë ndikimin e pengesave të ndryshme mbi intensitetin e zërit.

GJITHËPËRFSHIRJA, BARAZIA / NDJESHMËRIA GJINORE, INTEGRIMI INTERKULTUROR DHE NDËRLËNDOR

Mësimdhënësi siguron gjithëpërfshirjen duke i përfshirë të gjithë nxënësit, në të gjitha aktivitetet që zhillohen gjatë orës mësimore. Kështu, ai mundëson që çdo fëmijë të angazhohet në mënyrë njohëse dhe emocionale përmes qasjeve të duhura metodologjike (individualizim, diferencim, punë në grupe, mbështetje nga bashkëmoshatarët). Gjatë punës me nxënës me aftësi të kufizuara, zbaton plan arsimor individual (me rezultate të përshtatshme të të nxënës dhe të standarde për vlerësim) dhe gjithmonë kur është e mundur, shfrytëzon mbështetje nga persona të tjerë (asistentë personalë dhe arsimorë, ndërmjetësues arsimorë, mësues vullnetarë dhe profesionistë nga shkolla). Përcjell rregullisht të gjithë nxënësit, veçanërisht ata nga grupet e ndjeshme, që të mundet në kohë t'i identifikojë vështirësitë e tyre në të mësuar dhe t'i inkurajojë dhe t'i mbështesë ata në arritjen e rezultateve të të nxënës.

Gjatë realizimit të aktiviteteve, mësimdhënësi i trajton njëlloj si djemtë ashtu edhe vajzat, duke u kujdesur që të mos u ndajë atyre role me stereotipe gjinore. Gjatë formimit të grupeve të punës, përpunon të sigurojë një ekuilibër të barazuar gjinor. Gjatë përzgjedhjes së materialeve shtesë në mësimdhënie, përdor ilustrime dhe shembuj sensacional gjinor dhe etnik/kulturor, që inkurajojnë barazinë gjinore, përkatësisht promovojnë interkulturalizmin.

Gjithmonë kur është e mundur, gjatë planifikimit dhe realizimit të mësimdhënies, mësimdhënësi përdor integrimin e temave/përmbajtjeve/nocioneve. Integrimi ju mundëson nxënësve të përfshijnë këndvështrime nga lëndë të tjera mësimore me atë që mësojnë në lëndën e shkencave të natyrës dhe kështu të ndërlidhin njohuritë nga fusha të ndryshme në një tërësi.

VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

Për t'ju mundësuar nxënësve të arrijnë standardet e pritura të vlerësimit, mësimitdhënësi përcjell vazhdimisht aktivitetet e nxënësve gjatë mësimitdhënies dhe gjatë mësimit duke mbledhur informacione në lidhje me përparimin e secilit nxënës. Për pjesëmarrjen në aktivitete, nxënësit marrin informata kthyesë të cilat tregojnë nivelin e suksesit gjatë realizimit të aktiviteteve/detyrave dhe japin udhëzime për përmirësim (vlerësim formativ). Për këtë qëllim, mësimitdhënësi përcjell dhe vlerëson:

- përgjigjet me gojë për pyetjet e bëra nga mësimitdhënësi ose nga nxënësit e tjerë;
- kontributin në zbatimin e konkluzioneve;
- fletët e punës;
- realizimet praktike në formë jo të drejtpërdrejtë, të lidhura me standardet;
- detyrat e shtëpisë;
- përgjigjet në kuize (teste të shkurtra) që janë pjesë e mësimitdhënies.

Pas mbarimit të mësimit nga secila temë, nxënësit marrin vlerësim përmblendës në formë të përshkrimit, lidhur me të arriturat sipas standardeve. Vlerësimi përmblendës realizohet nga përparimi i konstatuar nëpërmjet teknikave të ndryshme të vlerësimit formativ.

Fillimi i zbatimit të programit mësimor	Viti 2021/2022
Institucioni/bartës i programit	Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Në bazë të nenit 30 paragrafi (3) i Ligjit të Arsimit Fillor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së veriut” nr. 161/19 dhe 229/20), ministrja e Arsimit dhe e Shkencës miratoi programin mësimor të lëndës <i>Shkencat natyrore</i> për klasën e I.	<p>Nr. _____ viti _____</p> <p style="text-align: right;">Ministrja e Arsimit dhe e Shkencës, Mila Carovska</p> <p style="text-align: right;">_____</p>